

## 9.12 BASHKËRENDIMI I REGJISTRIMEVE BIBLIOGRAFIKE ME ATO TË NJËSUARA

Me regjistrimet e njësuara janë të lidhura fushat për emrat vetjakë dhe emrat e organizatave nga blloku 7XX për të dhënat për përgjegjësinë.

Kur shënoni numrin identifikues të regjistrimit të njësuar në fushën për autorin (nënfusha 3) në regjistrimin bibliografik, në regjistrim shtohen të dhënat nga regjistrimi i njësuar:

- në fushën për emërtimin transferohet pikëqasja e njësuar nga regjistrimi i njësuar
- në fushat për variantet e emërtimeve transferohen variantet e pikëqasjes nga regjistrimi i njësuar
- në fushat për emërtimet në lidhshmëri transferohen pikëqasjet në lidhshmëri nga regjistrimi i njësuar

Këto të dhëna bashkërendohen në mënyrë automatike me gjendjen aktuale në bazën e njësuar CONOR sa herë që regjistrimi bibliografik ruhet.

Çdo natë në COBIB, në mënyrë automatike, aplikohet edhe pakoja e përditësimeve të regjistrimeve bibliografike.

Program i ngjashëm kujdeset për bashkërendimin e regjistrimeve bibliografike dhe të njësuar edhe në bazën lokale të të dhënave. Sa shpesh do të ekzekutohet ky program, varet nga marrëveshja me bibliotekën e veçantë.

Programi për bashkërendimin e regjistrimeve bibliografike dhe të njësuara fillimisht gjenë të gjitha regjistrimet e njësuara, të cilat:

- janë ndryshuar nga data e bashkëredimit të fundit deri në datën aktuale dhe
- në nënfushën 100b – *Kodi për statusin e pikëqasjes së njësuar* përmbajnë kodin "a" – *i vendosur* (d.m.th. pikëqasje e verifikuar) ose në nënfushën 001a – *Statusi i regjistrimit* përmbajnë kodin "d" – *regjistrim i fshirë* dhe
- në nënfushën 001a – *Statusi i regjistrimit* nuk përmbajnë kodin "r" – *regjistrim i ndarë*.

Më pas programi gjenë të gjitha regjistrimet bibliografike, të cilat në nënfushën 3 kanë numrat identifikues të këtyre regjistrimeve të njësuara. Në këto regjistrime bibliografike të gjitha fushat, të cilat përmbajnë nënfushën 3, bashkërendohen me regjistrimet përkatëse të njësuara.

Aplikohet procedura në vijim:

- Nëse nënfusha 001a – *Statusi i regjistrimit* në regjistrimin e njësuar

përmban kodin "d" – *regjistrim i fshirë*, programi kërkon nënfushën 001x – *Numri i regjistrimit zëvendësues*. Këtu është i shënuar numri identifikues i regjistrimit të njësuar, i cili do të zëvendësoj regjistrimin e përzgjedhur për t'u fshirë. Ky numër identifikues pastaj bartet në nënfushën 3 në regjistrimin bibliografik, ndërsa përmbajtja e mëparshme e nënfushës 3 bartet në nënfushën 9 – *Numri i regjistrimit të mëparshëm të njësuar*.

- Nëse në regjistrimin e njësuar ka një ose më shumë fusha 990 – *Rilidhjet* dhe në nënfushën 100b – *Kodi për statusin e pikëqasjes së njësuar* është i shënuar kodi "a" – *i vendosur*, programi kërkon për regjistrimet bibliografike, të përfshira në nënfushat 990b – *ID e regjistrimit bibliografik*. Në këto regjistrime në nënfushën 3 shënohet numri identifikues i regjistrimit të njësuar nga nënfusha 990n – *ID e regjistrimit të njësuar*. Përmbajtja e mëparshme e nënfushës 3 bartet në nënfushën 9.
- Më pas për çdo fushë, për të cilën vlen kontrolli i njësuar, aplikohet procedura në vazhdim:
  - Emërtimi uniform zëvendësohet me pikëqasjen e njësuar nga regjistrimi përkatës i njësuar, numri identifikues i së cilës është shënuar në nënfushën 3.
  - Nëse regjistrimi i njësuar përmban variante të pikëqasjes, edhe ato shtohen në regjistrimin bibliografik.
  - Variantet e mëparshme të emërtimeve fshihen nga regjistrimi bibliografik.
  - Nëse regjistrimi i njësuar përmban pikëqasje në lidhshmëri, edhe ato shtohen në regjistrimin bibliografik.
  - Emërtimet e mëparshme në lidhshmëri fshihen nga regjistrimi bibliografik.
- Në të njëjtën kohë krijohen edhe nënfushat 3 – *Numri i regjistrimit të njësuar*, të cilat shërbejnë si lidhje mes emërtimit uniform, varianteve të emërtimeve dhe emërtimeve në lidhshmëri.